



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 16, datë 30.01.2025

PËR

“CAKTIMIN E PÛRKOHSHËM NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM VLORË”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

1. Znj. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Z. Erind GERMENJI	Zv/Kryetar
3. Znj. Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
4. Znj. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
5. Z. Zeqir HODA	Anëtar
6. Z. Sokol STOJANI	Anëtar
7. Z. Moisi DUDA	Anëtar
8. Z. Vatë STAKA	Anëtar
9. Z. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Z. Erind MERKURI	Anëtar
11. Z. Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 30/01/2025, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”



BAZA LIGJORE:

- i. Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,
- ii. Neni 42, pika 2, Ligji Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- iii. Neni 59, Ligji Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- iv. Neni 3, Rregullore “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shoqërues Nr. 85, datë 14.01.2025, i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës;
- ii. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Për shkak të pezullimit prej KLP të prokurorit Aurel Zarka, zyra e prokurorisë Vlorë konform Urdhër nr. 16 datë 31.10.2022, ka vijuar të drejtohet nga zoti Arian Xhaferraj, i cili mban pozicionin e zëvendës drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
2. Bazuar në nenin 44 pika 4 e ligjit nr. 97 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, mandati i zëvendës drejtuesit është 2 vjet, ndërkohë që afati në fjalë përfundon në dt. 31.10.2024.

Për sa më sipër Këshilli i Lartë i Prokurorisë, konstaton se:

3. Në përfundim të këtij afati, pozicioni i drejtuesit të zyrës mbetet sërish vakant, ndërkohë që konsiderohet domosdoshmëri plotësimi i tij me qëllim garantimin e funksionimit normal të zyrës në fjalë.



4. Në këtë rast, KLP vlerëson të përdorë mekanizimin e caktimit të përkohshëm për plotësimin e kësaj vakance, duke vijuar më pas me hapjen e garës për plotësimin e pozicionit vakant, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

5. KLP vlerëson fillimisht të saktësojë se Caktimi i përkohshëm si mekanizëm ligjor me qëllim plotësimin e vakancës eventuale, legjitimohet të përdoret referuar;

- i. Nenit 42, pika 2, “... *Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.*”, Ligji Nr. 96/2016;
- ii. Nenit 59 , pika 1, “*Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të: caktimit në pozicione të tjera, arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji*”, Ligji nr. 96/2016;
- iii. Nenit 3 “*Kriteret për caktimin e përkohshëm të prokurorëve*”, i Rregullores “*Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve*”, miratuar me Vendimin Nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër*”.

6. Për të garantuar qëndrueshmërinë dhe stabilitet për aq sa është e mundur në drejtimin e kësaj zyre, Komisioni vlerëson të caktojë sërish në këtë detyrë prokurorin Erjon Shqarri. Zoti Shqarri ka mbi 8 vite vjetërsi si magjistrat dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi.

7. Në këtë kontekst, KLP referuar përcaktimeve, ligjore që shpreh neni 47 “*Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë*”, pika 6, e ligjit 96/2016, dhe rregullatore shprehur në nenin 8 të Rregullores “*Për ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit*”, konsideron kandidaturë të përshtatshme prokurorin Erjon Shqarri, si kandidat i cili plotëson kriteret për plotësimin e vakancës eventuale.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në ligjin nr.96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, nenin 42 pika 2 dhe nenin 59, si dhe neni 3 i Rregullore “*Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve*” e ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:



1. Caktimin e përkohshëm të prokurorit Erjon Shqarri në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për një periudhë tre mujore, duke filluar nga data 01.02.2025 deri në data 30.04.2025.
 2. Zoti Erjon Shqarri do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nga data 01.02.2025 deri në datë 30.04.2025.
 3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Erjon Shqarri, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare web të Këshillit.
- U shpall në Tiranë, sot më 30.01.2025.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erion Fejzulla

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Olger Eminaj